

RENIS HYKA
SAMSARA
DRAMË PA NJË AKT

BOTIMET TOENA

RENIS HYKA

SAMSARA

dramë pa një akt

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-11-4

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Dy fjalë në vend të hyrjes

“Ne jemi zgjedhjet tona”, shkruan Sartri dhe me këto fjalë ai përmbledh filozofinë e tij ekzistencialiste. Por ç’janë *Zgjedhjet tona*, çfarë synojnë ato? Synojnë lirinë, apo diçka tjetër? Nëse synojmë lirinë, lirinë nga çfarë, lirinë për çfarë? Nëse diçka tjetër, çfarë mund të jetë?

Por a jemi ne të aftë të kuptojmë *Zgjedhjen tonë*, madje a *Zgjedhim* vërtet ne? Nëse jo, nëse *Zgjedhjet tona* i bën dikush tjetër, a jemi ne “dikush tjetër”? A është liria jonë e mundshme, apo mbetet thjesht një iluzion?

“Ankthi është dehja e lirisë”, shkruan Søren Kierkegaard, duke e përcaktuar ankthin si një lloj matësi, dhe gjendjen e ankthit realitet të vërtetë të njeriut që koncepton zgjedhjen dhe lirinë. Sartri shkon më tej duke thënë: “Njeriu është vetë ankthi”, pra njeriu është edhe gjendje përtej të qenët trup. Kështu, krijohet një lidhje midis zgjedhjes, ankthit dhe lirisë.

Por ç’është “Samsara”? Si term në doktrinat e filozofive të lashta indiane nënkuptonte ciklin e

ekzistencës, pra lindjen, jetën, vdekjen e më pas rilindjen. Bashkë me samsarën, në të njëjtën filozofi gjejmë edhe dy terma të tjerë të lidhur me të: māyā (realiteti është thjesht iluziv) dhe avidyā (injanca metafizike ku ndodhet njeriu). Pra, njeriu (përherë sipas kësaj doktrine) jeton në një realitet iluziv nga i cili nuk del dot për faj edhe të injorancës metafizike që ka mbërthyer qenien njerëzore. Për këtë arsye (përherë sipas kësaj doktrine), njeriu i ngecur në samsarë është i dënuar të përsërisë ekzistencën e tij për një faj të paqartë. Kjo lloj doktrinë, që ka një frymë pesimiste, fataliste, apo dhe mohuese është e kundërta e asaj ekzistencialiste që kërkon të gjejë një rrugë në një labirint me mure të larta. Raporti zgjedhje-ankth-liri qëndron në të njëjtën paralele me māyā-avidyā-samsara, por në kahun pozitiv e kërkon të dalë nga paqartësia. Njeriu ZGJEDH, për të dalë nga iluzioni (māyā), dhe në zgjedhjen që bën (kur ai arrin ta konceptojë si të tillë) njeriu mbërthehet në ethet e ANKTHIT, sepse njeriu bëhet i vetëdijshëm që çdo zgjedhje e përcakton atë si individ. Ky lloj ankthi (le ta quajmë metafizik) është tregues çlirimi nga mpirja, nga injoranca metafizike (avidyā) që reflektohet me rëndomtësinë e jetës kuturu ku “zgjedhja” ka një

burim të largët nga ai që zgjedh. I gjithë qëllimi final (teoria ekzistencialiste) është LIRIA (ajo e plotë e qenies) për të qenë ai që vërtet je, për të realizuar ekzistencën tënde, për të dalë pra nga kurthi i ashtuquajtur Samsarë.

Por rikthehemi tek e njëjta pyetje: “A zgjedh njeriu? A e koncepton ai ankthin e zgjedhjes së tij? A e ka ai fuqinë të çlirohet nga iluzioni dhe të përmbysë injorancën e vet?”

“... njeriu modern ndodhet në një situatë ku në pjesën më të madhe të asaj që 'ai' mendon dhe thotë, konsiston në gjëra që gjithë të tjerët i mendojnë dhe i thonë; dhe se ai nuk ka fituar aftësinë për të menduar në mënyrë origjinale...”, thotë Eric From duke zhveshur “lirinë në dukje” kamuftuar si liri e vërtetë e qenies.

Pyetjet e lartpërmendura mund të mbeten retorike e çdokush mund të japë përgjigjet e tij në aktin e munguar të dramës. Unë më tepër se një përgjigje mund të jap veç një gjysmë të tillë: “Njeriu ka frikë të krijojë vetveten, të jetë individ, e kështu fle në shtratin e madh të shoqërisë ku ëndërrojnë të gjithë të njëjtat ëndrra dhe shohin së bashku të njëjtat makthe. A mundet të përmbushë njeriu qëllimin e vet nëse nuk ka një qëllim të vetin, por veç një të tillë kolektiv?”.

AKTI I

ATA DHE TI

SKENA I

Një apartament i modeluar pa luks, në qendër dy kolltukë, një divan, një pasqyrë muri e madhe varur në pjesën ballore të skenës. Një televizor disi më tutje në të djathtë. Majtas një tavolinë ngrënieje me katër karrige. Varur diku një orë muri. Mbi tavolinë një shportë. Në mur janë vendosur katër korniza me portrete. Një poç i ndriçuar rri i varur në qendër të skenës. E gjithë dhoma ngjan me një kub.

AI në dhomë i vetëm, ulur në kolltuk, me shpinë nga publiku, duke ndjekur televizorin.

Dëgjohet zëri që vjen nga televizori.

A mund të shtysh përpara, kur jeton në një botë absurde, ku arritjet e tua asnjëherë nuk mjaftojnë,

ku çdo sukses shkrihet në kohë, ku asnjë qëllim nuk përlligj të vërtetën e jetës, ku gjithçka është... thjesht asgjë?

AI (Përgjigjet instinktivisht mbyturazi.)

Jo!

Përsëri televizori

A jemi ne të gjithë “sizifë” të kurdisur nga absurditeti i ekzistencës? (*Heshtje e shkurtër.*) Po, të dashur njerëz! Po, sepse është koha e marrëzisë, e kotësisë dhe e gjithë kjo vetëm për fajin se nuk jemi ata që duam, ose s’duam të bëhemi ata që vërtet jemi! Ai që jeton pa arsye, pa kriter, gjithmonë i papastër, nuk arrin të jetë vetvetja, por bie në ciklin e ekzistencave! E ekzistencave! E ekzistencave! E ekzistencave...

AI fik televizorin me anë të telekomandës. Kthen kokën të vështrojë orën e murit në një cep të largët të dhomës.

AI (Monolog, zë mekanik pa emocion.)

7 e 10! E martë! Ata do të vijnë pas 20 minutash, e deri atëherë më duhet të pres. S’kam ç’bëj, rutina është kthyer në zakon. Nuk dal dot nga kjo vorbull

që më ka përpirë. Këto 20 minuta do kalojnë duke qëndruar ulur në këtë kolltuk, ose duke u vërdallisur nëpër dhomë, i dënuar të rri brenda saj, si ditët e shkuara, derisa ata të hyjnë nga ajo derë, fiks në 7 e 36! S'do vijnë as më herët e as më vonë, dhe të dish me saktësi ç'do të ndodhë është e frikshme. *(Merr frymë.)*

Pas 19 minutash do të hapin derën, do të më përshëndesin, do të pyesin “Si ia kalove sot?”. Unë do të them “Mirë!”, si përherë. Më pas do t'i pyes unë, e ata e do të më përgjigjen se dita ishte e lodhshme, e mërzitshme e të tjera si këto.

Hesht një çast që zgjat.

Dëgjohet vetëm tiktaku i orës.

Ai të do marrë gazetën dhe do të ulet të lexojë këtu përballë meje. Ajo të do shtrojë tavolinën. Unë do të pres! Më pas do të ulemi për të ngrënë darkën. *(Mendohet.)* Madje edhe çastet përsëriten deri në detaje! Kjo nuk kalohet pa frikë. Përsëritja pa ndërprerje është frikë që i përngjet çmendurisë. *(Sheh nga dhoma.)* Dhoma! Po kjo *(sheh nga ora e murit)*, ora rrotullohet me të njëjtin avaz. Koha ikën por s'di

çfarë është ndryshe për mua... (*Papritur me zë më të gjallë.*) Rri e pres që të vijnë ata, më pas do të mbushim barkun si çdo mbrëmje, do të hamë darkë në orarin e zakonshëm, në të njëjtën tavolinë, ulur në po ato karrige, me të njëjtat pjata. “Ditë e bukur sot!”, më tha dikush qëparë. “Është e martë!”, ia ktheva. (*Hesht dhe ngrihet nga kolltuku, vërdallë nëpër dhomë.*) Uria më vjen vetvetiu, ka orën e vet, ashtu si neveria ime për gjendjen, që zgjohet sa herë bie zilja e zgjimit në mëngjes, saktësisht në 7 e 15. Neveria, kjo ndjenjë që ma bën ditën më të lehtë! Po, po, pa atë do të vdisja shpejt nga marazi! (*Hesht një çast, pastaj vazhdon më qetë.*) Jeta ime është e bukur! Këtë ma thonë të gjithë. Nuk u besoj njerëzve që njoh prej vitesh, por kur ma tha dhe një i panjohur, besimi të “jeta ime e bukur”, gjeti një bazë ku të mbështetet. Njeriu gënjehet lehtë kur ia bëjnë qejfin, nga dëshira për të gëzuar priret të besojë edhe gënjeshtren më të poshtër. (*Hesht, shkon e ulet në tavolinën e ngrënies.*) Darka, ky ritual i përsëritur që prej kaq kohësh duket se do të vazhdojë deri në plakje. (*Çohet sërish.*) Në tërë këtë histori kam përshtypjen se dikush po vendos për mua e ai s’jam unë, unë vetëm po e lë këtë vullnet të huaj të drejtojë jetën time.

E kush mund të jetë kjo dorë e fshehtë? (*Duke vështruar kureshtar nëpër dhomë.*) Një lëvizës i palëvizshëm? Një shkak me qëllim të paditur? Një Zot? Ndoshta fati, apo... mos janë njerëzit? (*Vështron nëpër dhomë sikur pret përgjigje.*) Po ata, të gjithë ata! (*Mendohet.*) Jo, jo, unë jam fajtori! Të tjerët janë vetëm bashkëpunëtorët që e bëjnë të plotë plogështinë time, e më e keqja është se nuk kam ç'bëj tjetër, më duhet të pranoj këtë vullnet që më shtyn. Kam parasysh zhonglerët! Unë jam i zhongluari! Po, po, i zhongluari! Ai që mendon se bën spektaklin, por është veç levë e komedisë! E herë të tjera e gjitha duket si e shkruar, ku unë jam spektatori e bota jep shfaqje, pastaj ata më japin një rol! Rol dytësor, ose tretësor, kuptohet! Vullneti i kësaj bote, i këtij filmi është më i mistershëm se imi, më i fortë se imi, për besë dhe më i shëmtuar! Unë lexoj në mimikat e të tjerëve pjesën time, ku jam caktuar të pres, ose të ha darkën e të martës mbrëma! Mundohem të luaj mirë. Sa herë i shtoj rolit diçka timen, sytë e tyre bëhen të shtrembër, e tmerrësisht depërtues. Por deri më tani askush s'më ka thënë: "Po, ti e luan mirë pjesën!", por as: "Ti je i dështuar!". Mungesa e kritikës mund të merret si pozitive, kur bën gabime

askush nuk ta përton, sytë e tyre depërtues bëhen dhe kamxhikë. *(Duke lëvizur nëpër dhomë, me zë të shuar, sikur flet përçart e i dëshpëruar.)* Shkak-pasojë, shkak-pasojë. Shkak... *(përballë pasqyrës së murit)* pasoja është ky njeriu këtu! *(Vështron veten me ngulm e gjatë.)* Nëse shihem gjatë në pasqyrë do të mëshiroj veten! Duke i parë këta sy e kuptuakam mirë shpirtin tim që në mos i shuar, duket krejt i venitur, si një copë leckë e varur që rrihet nga gjithë erërat e laget nga të gjithë shirat!

Largon vështrimin nga pasqyra, bën ca hapa pas, e rikthen prapë shikimin, tani më i larguar se më parë.

A jam unë ai aty? Më ngjan! *(Me zë më të lartë.)* Shok, a je ti unë? *(Hesht sikur të presë përgjigje.)* Si? E kuptova, këtë mendoj dhe unë, që nuk e di! Kush e di? Kam kohë që s'e di! *(Shfryn.)* S'e kam ditur kurrë! Njeriu është qenia që pret të bëhet vetvetja, e ndërsa pret, të tjerët e kanë kthyer në një gaztor. Unë mund të jem çdokush, por jo ai që kam besuar gjithmonë! *(Duke germëzuar me zë të ulët.)*
GAZ-TOR!

*Vjen vërdallë nëpër dhomë duke germëzuar fjalën
“GAZTOR” në mënyrë monotone, derisa ulet në
kolltukun tjetër me vështrim nga publiku.*

Darka e gaztorit! E di se ç’do të ketë sonte për darkë, të njëjtën e të martave, madje stomaku ka filluar prej orësh të përtypë shijen e gjellës së sotme. *(I hedh një shikim orës së murit.)* 7 e 17! Darka. E martë! As më pak e as më tepër kripë. *(Sheh sërish orën e murit.)* Edhe 13 minuta. Të paktën të ketë më tepër piper, le të më përcëllojë, mjaft që mos jetë po njëlloj. “Njësojllëku” më bën me dhimbje stomaku, më vonë do të më bëjë me dhimbje koke, ndoshta një ditë edhe mund të më vrasë. *(Qesh hidhur, shton zëulur.)* Të më vrasë, patjetër, të më vrasë, në qofsha i gjallë. Jam 33 vjeç, por nuk i kam jetuar të gjitha këto vite.

*Ngrihet, ecën mendueshëm nëpër dhomë, e i flet
vetes në pasqyrë.*

Po më vonë? Më vonë si çdo të martë në 8 pa 5 do të më telefonojë Merita. Sa shumë më do ajo mua! Ma ka thënë një milion herë! Po, po, një milion! Jeta i ka këto, përsëritjet e bajatshme! Por

unë kam një ves të keq, nuk u besoj atyre që ma përsërisin diçka më tepër se tre herë. Ti do të thuash “Pse?”. Njerëzit kur duan të gënjejnë pikërisht këtë bëjnë, e përsërisin gënjeshtren aq herë sa ta besojnë dhe vetë! (*Sheh nga ora.*) Pas 37 minutash Merita do të më telefonojë e do të thotë të njëjtat fjalë: “Sot është e martë, kemi takim!” Unë si përherë do t’i përgjigjem: “Po, e di”. Më pas, si të martën e shkuar, do të dalim e do të ulemi në të vetmin vend që ajo do të ulet të martave, do të porosisim të njëjtat pije si të martat e 4 viteve të fundit që dalim, 4 vite të gjata; të gjata, por krejt të njëllota. (*Afrohet te pasqyra, gishtin tregues e vendos te koka e tij në pasqyrë, zëlartë.*) Janë katër vite, janë 200 të marta! Kupton? Janë një milion herë “Sa shumë të dua”! A mund të shpëtojë dikush pa besuar gënjeshtren e përsëritur një milion herë? Përveç kësaj, kujtdo do t’i ishte mërëzitur dashuria! Ndoshta gabohem e ajo më do vërtet, por vesi im i mosbesimit është kokëfortë! S’jam e para viktimë e vesit të vet! (*Mban supet ngritur për një çast, vazhdon dialogun me veten në pasqyrë.*)

Ç’mbah mend nga gjithë kjo kohë? Po më pyet vërtet? (*Mendohet pak.*) Asgjë përveç një milion herë të të njëjtave fjalë! Pyes në kanë vlerë kohët që s’mbahet mend! (*Mendohet.*) Pak, pak fare. Në

katër vite vetëm ca vogëlsira! Njeriu çdo gjë me rëndësi e mban mend pa u sforcuar, harresa është treguesi i një periudhe të palumtur, kështu natyra tenton të shpëtojë shpirtin e njeriut nga melankolia. Këtë bindje kam, dhe bindjet e mia janë e vetmja gjë për të cilën jam i sigurt, qoftë gabimisht! (*Sheh veten me vëmendje në pasqyrë.*) Por vetëm tani po u bëkam kaq i vetëdijshëm për kohën që kalon si lumë e unë nuk zë asnjë peshk! Doemos, ende nuk kam hedhur grepin! Po pse sot e paqarta po qartësohet? Ndoshta se veç sot po e shoh veten me kaq imtësi në pasqyrë! (*Duke afruar fytyrën te pasqyra që të shohë më mirë.*) Shoh shenja të thella, këto vula e damka në fytyrë. Sot po i shoh këta sy pa jetë, këtë buzëqeshje të vdekur, gjithë këtë shëmti të thellë të fytyrës sime! S'e dija që isha kaq i shëmtuar! (*Ikthen shpinën pasqyrës, pastaj kthen pak kokën dhe sheh me bisht të syrit.*) Edhe helm shoh, shumë helm. (*Largohet në brendësi të dhomës.*) Mëngjeseve i hedh kësaj fytyre dy pëllëmbë ujë për ta larë, bëj sikur e shoh, por hiç. Çdo mëngjes mendja sheh me sy të mekur fytyrën që unë gabimisht pandeh të jetë e imja, shoh atë që mendoj se mbart, atë që është krijuar nga fjalët e atyre gaztor-krijuesve, por jo damkat e mia. (*Shfryn.*) Gaztor-Krijues!

Kuturu nëpër dhomë, duke përsëritur fjalët Gaztor-Krijues, me duart mbërthyer pas shpinë.

Sot është e martë e jam 33 vjeç, jam më i shëmtuar seç pandehja, kam më pak nerva, më pak vullnet dhe më pak kohë për të bërë atë që dëshiroj, edhe pse në të vërtetë nuk e di ende se çfarë drejtin dua! Tani më lindi kjo dëshirë narciste ta shoh veten gjatë në pasqyrë e të dalloj aty gjithë njollat e gjithë gërvishtjet e jetës, të shoh formën e buzëve të mia dhe rrudhat anash syve. Eh, rrudhat e syve, sidomos ato. Në gjithë këto detaje është shkruar jeta e njeriut, ashtu si te fjalët e thëna pa vetëdije. Por kam frikë se do të dalloj në këtë fytyrë të shëmtuar tërësinë e vuajtjeve që kurrë nuk u nxorën me zë, ato që i kam fshehur me kaq fanatizëm në shpirt! “Shpirt”, hah! (*Buzëqesh ironikisht.*) Sot do të ha darkë, por shpirti im është ngopur tashmë me fjalët e përditshme të njerëzve të përditshëm! “Ti je i lumtur!”, më përsërisin ata. Unë i dëgjoj, dhe më bëhet qejfi! “Shpirti”, nuk e di ç’është, por që ushqehet me llafet e njerëzisë jam i sigurt, nuk ka dhëmbë të fortë dhe ndonjëherë i gëlltit fjalët ashtu siç janë! (*Afron kokën te pasqyra.*) Gjithë këto damka fytyre! (*Pastaj sheh orën.*) Edhe 7 minuta

janë këtu, kurse vullneti do të vonohet dhe pak! Vullneti im është si një kalë i garave me pengesa, por në vend që t'i kapërcejë pengesat, u bie rrotull. Gjë e zgjuar, kështu unë rri ulur këtu e pres që ai dhe ata të vijnë. Vullneti dhe prindërit, domethënë! Njëherë guxova, por u rimendova dhe lashë për më vonë, më vonë e lashë për të nesërmen, të nesërmen e shtyva për javën tjetër e kështu kaluan muaj e vite dhe ende jam këtu në vend, ende në pritje. (*Sheh orën.*) Me sa duket nuk po pres vetëm ata. “Pritja” është pritja e një dite më të mirë që vonohet e ne përgjumemi. Koha shkon e do të vazhdojë të ikë, unë jam i pafuqishëm ta ndaloj, sado larg të jetë fundi, bëhet përherë më i afërt. Çerek dite ma merr gjumi, më pas punë zyre, darkë, takim, gjumë, punë, gjumë, rutinë, më pas martesë, punë, më tej fëmijë, përsëri punë zyre, prapë deri sa të jem bërë, siç thonë ca eufemistë, një fisnik i thinjur, ose më saktë, një gjysmënjeriu me një këmbë nën dhé. Është më e këndshme ta mendosh “gjysmën e njeriut” nga mesi e poshtë, sepse s’dua t’ua shoh sytë e gjymtuar atyre fisnikëve, por edhe gishtat e këmbëve të mpira nga pritja ma shpifin njëlloj. Gjithsesi gjysmë apo çerek, të gjithë përpiqen ndonjëherë për të njëjtën gjë, të bëhen ata që janë,

por me intervale të gjata pritjeje. Lum ai që s'pret. Lum ai që është i paduruar! Vrapon të bëhet njeri! Të tjerë bëhen shumë vonë, ose kurrë, kurse sot për drej është përsëri e martë e unë jam ende në pritje. Asnjë befasi nuk pres, asnjë surprizë, dhe e marta vjen shpejt, çdo shtatë ditë. Ndoshta para se të fisnikërohem e të thinjem do të më marrë përpara ndonjë makinë nën dritën e qartë të diellit, ose do të sëmurem për vdekje e do të vdes në një dhomë të ftohtë spitali! Më mirë makina! Të ftohtin nuk e duroj dot! Makinë dhe pranverë, ose verë! Vjeshta është shumë e bukur dhe e lagësht për të vdekur! Por deri atëherë duhet të rri në pritje, si sot, si dje, si nesër, që të vij në ata, apo që diçka ndryshe të ndodhë në këtë universin tim ku jam veç një satelit. Vij vërdallë duke qëndruar në vend! E hatashme! (*Ecën kuturu.*) E përsëritur, e përsëritur gjithë kjo jetë. Por ata s'më kuptojnë, ata kanë ligjet e tyre, zakonet edhe sesi të kalojë koha e të thinjen hijshëm. Sado që t'ua shpjegoj, ata s'do të jenë në një mendje me mua, kanë sektin e tyre të plakjes! Ndoshta asnjë që njoh s'do të dojë të më kuptojë. As unë vetë nuk e kuptoj veten time. E di që kam të drejtë, por s'e kuptoj. Jam kthyer pothuaj si ata, më kanë marrë përpara.

(*Kokulur, heshtje e shkurtër.*) Sonte s'do të ha fare darkë.

Heshtje, ecejake nëpër dhomë.

Do të ha apo jo, askujt nuk i bëhet vonë, as mua. Nesër prapë rinis e njëjta histori. (*Ulet në kolltukun ku ishte në fillim.*) Mëngjes! Në 7 e 15 do të bjerë zilja e zgjimit, do të zgjohet së pari neveria brenda meje, pastaj unë, e si çdo ditë jave, do të bëhem gati të shkoj në punë, ngarkuar mirë me duf, drejt të njëjtës punë që e bëj prej kohësh, aty ku përsëriten gjërat siç përsëritet një reklamë në televizor për muaj me radhë sa mësohet përmendesh çdo lëvizje, e çdo detaj sado i vogël. Një aktor reklame që e luan mirë rolin e tij. Si të gjithë! Përveç filmit, të gjithë kanë dhe reklamën e tyre, domethënë kohën ku shesin veten. Të gjithë janë aktorë diku! Kot nuk thonë se të gjithë janë artistë, të hequrit me skrupuj kur je meskin është art që lind natyrshëm, një instinkt i pafuzueshëm! Kurse të përsëriturit është ves që fitohet shpejt. (*Ngrihet nga kolltuku, ecën mendueshëm nëpër dhomë.*)

E lashë te puna ime! Një kohë doja një punë të mirë, por sot kuptoj se po kërkoja vrasësin e kohës të jetës sime. Kam gjetur një vrasës deri diku të

mirë e të heshtur. Dhjetë vite më parë mora një diplomë. Sa u gëzova! Fatmirësisht nuk kam asnjë fotografi nga ajo ditë! Por të tjerët u gëzuan edhe më shumë dhe fotografitë e tyre i shoh sa herë ata më dalin përpara. Edhe të verbrit janë të bekuar në këtë pikë, nuk e njohin atë që unë quaj “e bukura më e neveritshme”, domethënë fytyrat e pseudolumtura njerëzore që lodhen së qeshuri me zor. Por sot hareja e tyre më duket edhe e kobshme, si buzëqeshja e xhelatit drejtuar viktimës, një çast para aktit final! Bam, koka dhe mendja tutje, duke u përpëlitur në agoni! Një agoni e gjatë është emri i duhur për jetën e disave! (*Shfryn duke psherëtirë.*) Ndoshta ishte e martë kur kërkova punë dhe e gjeta shpejt, më pas doja një punë më të mirë, të mërkurën e gjeta dhe atë! Ose të enjten! Punë të mirë! “Të mirë”, një sekondë! Ai njeriu i dikurshëm që mban emrin tim e dinte ç’do të thoshte kjo fjalë, ky i sotmi, bah, s’di më asgjë! Punë të mirë s’ka! Por ka ego, dhe ajo u rrit! Doja të isha lart, sa më lart, se për ku, një djall e di! (*Hesht.*) Sot jam nëndrejtor, por asgjë nuk është më mirë se dikur. Nuk e kam thënë kurrë, e ruaj si sekret faktin se më të shumtat e ëndrrave që shoh janë me histori parash! E kam fjalën edhe për ëndrrat symbyllur! Jeta e nëndrejtorit është kaq e mërzitshme! E kam të vështirë të bëj diçka

ndryshe dhe rutina ime është një ndër versionet e kapitullimit, ose një lloj parapërgatitje. Kjo lloj pune e pështrirë është dënimi im për rrogën e lartë që marr, fajtori për gjellën e të martës mbrëma dhe shkaktari i çorbës që shpirti im gëlltit çdo ditë të bekuar! Dhe unë 33 vjeç jam nëndrejtor, kam jetuar pak, s' di ç'kërkoj nga jeta dhe e kam parë veten rrallë në pasqyrë. 33 vite, kaq shpejt i dënuar për të marrë rrugën e drejtorit dhe të shokut Sizif njëkohësisht. (*Sheh drejt pasqyrës, lëshon papritur një britmë të shkurtër, flet si i tërbuar.*) Jooo! (*Vrapon nëpër dhomë.*) Jam veç një maskara! Maskarai i vetes sime! (*Ndalon një moment, vështron vërdallë e i heshtur, dëgjoet frymëmarrja me gulçe, vazhdon qetë si më parë.*) Mbaje veten! Të gjithë janë maskarenj të vetvetes! (*Tjetër ton zëri.*) Por të tjerët s'më hyjnë në xhep, mua më intereson vetëm ai tipi që më del përballë sa herë afrohem te pasqyra! (*Ecën i menduar, sheh orën e murit.*) Edhe një minutë dhe pastaj magjia! (*Vijon ecejaket me ngadalë.*) Por e kotë, e kotë...

I mërzitur.

Është dhjetor dhe në verë do të martohem. Meritë, e dashur Meritë! E përsëritura Meritë! A

ia vlen të martohesh, që jeta të bëhet një film fund e krye njësoj? “Ajo është vajzë e mirë”, thonë ata. “E mirë!” (*Buzëqesh hidhur.*) Punë e mirë, vajzë e mirë! “E mira” nuk m’u nda! Martesa duket si “çdo ditë që i ngjan të martës!”. Qëllimi? Që të fisnikërohëm? Shumë bukur! (*Ndërkohë ndalon e tund kokën gjatë në shenjë mohimi.*) Sonte s’do të dal fare. Madje as nuk do të martohem. Dhe punën do ta lë. Në mos sot, kur? Ka ditë plot, thonë ata, por duhet të bëhem shurdh... shurdh!

Zhurme nga dera. Shpërfillës.

Erdhën!

AI

“Viti i fundit i punës”, duket ngushëlluese, por asgjë e re! I prisja këto përgjigje! “Ditë e lodhshme, ditë e mërzitshme”, e dëgjuar, shumë e dëgjuar! Çdo ditë kështu është, një hap më afër, më afër! (*Kërcet gishtat.*)

NËNA

Më afër kujt?

AI (*Kollitet.*)

Thjesht doja të thosha se keni kohë që ankoheni për ditët, sa më duket se jeta ka qenë përherë e vështirë dhe e mërzitshme.

BABAI

E sigurt është që s'ka qenë asnjëherë e lehtë.

AI (*Serioz.*)

Kjo vihet re sa herë hyni ju nga ajo portë! Sillni një mimikë të tillë që i tregon të gjitha! Fjalët janë të tepërta! Qëllimi i së gjithës ka humbur! Koha nuk përton!

Nëna del nga dhoma, i ati heq pallton e ulet në kolltukun përballë tij, merr një gazetë dhe fillon të lexojë. Gazeta i mbulon fytyrën.

AI (*I drejtohet të atit.*)

Kur ka qenë hera e fundit që dita jote ka kaluar mirë?

BABAI (*Gazeta i mbulon fytyrën.*)

Eh, kush e kujton, por ka kaluar shumë kohë! Kënaqësia është për të rinjtë dhe pasanikët. (*Shfleton një faqe gazete.*)

AI (*Shpërfillës.*)

Çudi në fakt, as në moshën time s'po gjej kënaqësi. Duhet të jetë fshehur diku! Kam gjetur vetëm një rehati “mendjempirëse”!

BABAI *(Pa shumë habi.)*
Ç'është kjo?

AI
Një lloj boshllëku të rehatshëm.

BABAI
Ah, e kuptova, rehatia! Rehatia, bir, është oaza e jetës! Gëzoje sa e ke!

AI *(Po shpërfillës.)*
Për ata që jeta është vetëm shkretëtirë, kjo oazë është thjesht një mirazh!

BABAI
Kush janë këta të shkretëtirës? *(Shfleton një faqe gazete.)*

AI *(Me zë mekanik.)*
Beduinët e qyteteve! Domethënë shumica e njerëzve. Të gjatë e të shkurtër, të rinj e të vjetër, të pasur a jo, me ose pa mustaqe! Mjafton të shihesh në pasqyrë me pak kujdes.

BABAI
Ç'do të thuash? *(Shfleton një tjetër faqe gazete.)*

AI (*Vijon të flasë pa emocion.*)

Asgjë me interes, vetëm që sot është e martë dhe unë jam në pritje të darkës. Por në mëngjes shihu gjatë në pasqyrë. Shihu! Sa për darkën, me siguri edhe ti e di ç' do të hamë sonte?

BABAI

Kam një ide! (*Shfleton një faqe gazete.*)

AI

S'është mëkat të kesh ide, mëkat është se idetë janë po ato të vjetrat. Ti e di si lindi mëkati?

BABAI

Duke kafshuar një mollë! (*Duke ulur pak gazetën të shohë djalin, qesh shkurt e rëndë.*)

AI (*Shpërfillës.*)

Jo pa interes! Por të përsërisësh të përsëriturën është edhe më afër të vërtetës së mëkatit! (*Ngrihet nga kolltuku.*) Ai kafshoi mollën, se përndryshe do të vdiste nga mërzia!

BABAI (*Pa hequr sytë nga gazeta.*)

Askush nuk flet për mërzi!

AI

Askush nuk e ka zakon të flasë për sëmundjen e vet! (*Duke iu afruar të atit.*) Jam kureshtar ta dëgjoj edhe njëherë përrallën që më tregoje dikur kur isha fëmijë!

BABAI

Ende e kujton?! (*Shfleton një faqe.*)

AI

Çdo ditë, edhe kur nuk e çoj ndër mend!

BABAI

Unë di që je rritur me kohë!

Ai tashmë është fare pranë të atit, afron kokën te gazeta.

AI (*Ton disi agresiv.*)

Si mund të harrohet diçka e treguar një mijë herë në kohën ku s'dija asgjë! Tregoma pra, dhe njëherë! (*Largohet disi.*)

BABAI

Nuk ka të njëjtin kuptim përralla kur ia tregon një tridhjetecavjeçari! (*Shfleton një faqe gazete.*)

AI

Pikërisht! Sot dua ta dëgjoj që në fund të historisë të mos them si dikur “I shkreti njeri!”, por ta duartrokas duke thënë “Kështu duhet, mik, bëre atë që të tjerët duan të bëjnë!”.

Heshtje, i ati ul pak gazetë, shihen.

AI

Po pres, tregoma! (*I ati vijon leximin e gazetës pa i kthyer përgjigje.*) Atëherë, meqenëse nuk ke dëshirë po e tregoj unë! (*E tregon duke folur me shumë nxitim.*) Na ishte njëherë një mbret e një mbretëreshë që kishin një kopsht! Parajsë! Aty jetonte dhe një i mjerë që vetëm vinte vërdallë e priste! Priste, priste, priste... ferri! Ata e kishin lejuar të mjerin të hante nga çdo pemë përveç mollës, por një gjarpër i mësoi se ajo ishte pema e njohjes. Ai hëngri mollën, u bë i lirë dhe mbreti e mbretëresha e dëbuan. Kaq!

BABAI (*Pasi shfleton një faqe gazete.*)

Kaq! I re tepër shkurt, unë e mbaj mend pak ndryshe.

AI

Thelbi është i njëjtë, që liria ka çmim!

BABAI

Madje dhe goxha të shtrenjtë! (*Shfleton një faqe gazete.*)

AI (*I afrohet, me dorë ul pak gazetën, mjaftueshëm për t'u parë në sy.*)

E di! Por a ia vlen? (*Vështron të atin, i cili nuk i përgjigjet, më pas largohet për në qendër të dhomës.*)

Heshtje. Babai vijon leximin, shfleton një tjetër faqe, s'bën zë. Ai vështron orën.

AI (*Ndër vete.*)

Shtatë e dyzetë e pesë.

BABAI

Sot është e martë, apo jo?

AI

Si çdo ditë! (*Ngrihet dhe vështron të atin, i cili s'ia ndan sytë gazetës, me pas shkon te tavolina, merr një mollë dhe e kafshon. Duke u mbllaçitur.*)

A e di kë më kujton ajo përrallë?